



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1338_06_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **03.07.2015**

në seancën e mbajtur më datë 16 korrik 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F. G. me shifër DPR - 90061440 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1338_06_15** i datës 01.06.2015.

A r s y e t i m

Me datë 06.02.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 12448757 me gjendje TL=008941 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=010870 kWh (tarifa e ulët), si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.35023987 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 04.03.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën shkurt 2014 me shpenzim prej **1,591 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **133.25€**, me datë 03.04.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2014 me **1,844 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **158.35€**, si dhe me datë 03.04.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën për periudhën shtatë ditore 31.03.2014 - 07.04.2014 të energjisë elektrike me **302 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **12.28€**.

I pakënaqur me ngarkesat e bëra nga ana e KEDS konsumatori me datë 10.03.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kërkuar kontrollin përkatësisht shqyrtimin e njehsorit elektrik. Me datë 05.08.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 0000436 datë 19.06.2014 si dhe rrjedhën e energjisë elektrike.

I pakënaqur me përgjigjen e KEDS, konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK/ZRRE, pas kësaj DMK ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 01.06.2015 ka nxjerr vendimin me të cilën ka refuzuar ankesën e konsumatorit bazuar në dëshmitë e paraqitura nga palët.



Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe në ankesë ka kërkuar që t'i shlyhet pjesa e borxhit prej 400€ e cila sipas tij është jashtë rregullit dhe normave, ku si arsyetim ka dhënë ngritja e shpenzimit prej 225% krahasuar me mesataren e përgjithshme. Konsumatori në ankesë gjithashtu thekson se ka prova se njehsori i parë me numër 12448757 vazhdimisht ka regjistruar me rritje.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16 korrik 2015 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se vendimi i DMK-së nuk është i mbështetur ne prova dhe në ligj.

Lidhur me pikën e parë të kundërshtimit nga ana e konsumatorit që sipas tij duhet t'i shlyhet vlera e borxhit prej 400€ e cila vlerë është jashtë rregullit dhe normave, ku edhe si arsyetim ka dhënë ngritjen e shpenzimit prej 225%, Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se një arsyetim i tillë nga ana e konsumatorit nuk qëndron dhe nuk është i mbështetur në prova dhe fakte konkrete. Vlera e kërkuar për tu shlyer prej 400€ askund nuk është e evidentuar në pasqyrën financiare të konsumatorit, përveç se në pasqyrë financiare janë të paraqitura vlera të ndryshme financiare të cilat ka qenë i obliguar konsumatori t'i paguaj sipas shpenzime që ka bërë.

Sa i përket arsytimit tjetër se te konsumatori kemi rritje për 225%, kjo nuk është kontestuese për ZRRE-në, pasi që ketë fakt e ka konstatuar edhe DMK ne vendimin e shkallës së parë ku ka bërë analiza detale lidhur me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike për të gjithë njehsorët elektrik që ka pas në funksion konsumatori. Nga analizat e bëra nga DMK/ZRRE lidhur me mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike ka dal se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e regjistruar në njehsorin elektrik nr. 12448757 për periudhën 06/2010 deri në periudhën 01/2014 është **446 kWh/muaj**, ndërsa me njehsorët e ri nr. 35023987 dhe nr. 63541580 për periudhën 02/2014 deri më 04/2015 është **1,451 kWh/muaj**. Bordi i ZRRE-së ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike mes njehsorëve të cilët konsumatori i ka pasur dhe i ka në funksion dhe ka vërejtur se: mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike nr. 12448757 është 440 kWh/muaj (06/2010 – 02/2014), e njehsorit elektrik nr. 35023987 është 1,867 kWh/muaj (02/2014 – 04/2014), ndërsa e njehsorit elektrik nr. 63541580 është 1,528 kWh/muaj (04/2014 – 04/2015).

Pika tjetër e kundërshtimit të konsumatorit është se i njëjti ka prova se njehsori i parë me numër 12448757 vazhdimisht ka regjistruar me rritje. Bordi i ZRRE-së, pas analizimit dhe vlerësimit edhe të kësaj pike ka konstatuar se përkundër asaj çka është theksuar nga ana e konsumatorit në ankesë shpenzimet e energjisë elektrike në njehsorin me numër 12448757 kanë qenë dukshëm më të vogla se sa shpenzimet e paraqitura me dy njehsorët e ri që janë vendos më vonë ne ketë pikë matëse. Bordi gjithashtu ka konstatuar se konsumatori nuk ka ofruar asnjë provë të vetme për të argumentuar atë që thekson në ankesë se ka prova për ketë çështje, dhe për me tepër nuk ka bërë asnjë analizë të rrjedhës se energjisë elektrike për të ardh te një konkludim i tillë për atë që e ka theksuar ne ankesë. Përkundër kësaj nga analizat e bëra si në vendimin e shkallës së parë vërehet se është një gjendje krejtësisht tjetër nga ajo që theksohet në ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.07.2015 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1338_06_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar